



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT

Nr. 8524 prot

Kamëz, më 11.8.2026

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

**SHPALLJE E VENDIT VAKANT PËR POZICIONIN DREJTUES TË KOPSHTIT NR.22
BASHKIA KAMËZ .**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “për Vetëqeverisjen Vendore”; në Ligjin nr.48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar;

Drejtorja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, institucion në varësi të Bashkisë Kamëz, shpall vendin vakant për pozicionin e Drejtuesit për Kopshtin nr.22 Bashkia Kamëz .

Kandidati për drejtor i institucionit publik të arsimit parashkollor duhet:

1. Të zotërojë arsimim si mësues sipas përcaktimeve në nenin 57,të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ;
2. Të ketë përvojë pune si mësues;
3. Te ketë të paktën kategorinë “Mesues i Kualifikuar” me vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin e fundit;
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

Çdo kandidat duhet të dorëzojë **me postë** pranë Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dokumentacionin e mëposhtëm, **jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së këtij njoftimi:**

1. CV-në dhe kopjet e njehsuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të .
2. Kopjen e njehsuar me origjinalin të librezës së punës.
3. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
4. Çertifikatën e trajnimit për drejtues të institucionit arsimor parauniversitar ose vërtetimin që është në proces trajnimi, (nëse e disponon).
5. Vërtetimin nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore .
7. Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 4 të Udhëzimit nr.22 datë 13.11.2023)
8. Deklaratën e konfliktit të interesit .(sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 3 të Udhëzimit nr.22 datë 213.11.2023)

Dorëzimi i dokumentacionit do të kryhet **me postë** për Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në Bashkinë Kamëz **deri më 24.08.2026**

DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT